



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V
Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport
Mbledhja nr.06
Prishtinë, më 27.02.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT

Në mbledhje morën pjesë: : Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Teuta Haxhiu, Mufera Sinik dhe Shukrije Bytyqi, anëtarë.

Munguan : Shpejtim Bulliqi dhe Jelena Bontiç, anëtarë.

Pjesëmarrëse e ftuar: Ferdije Zhushi Etemi - Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri, Shaip Goxhuli dhe Blendina Krasniqi praktikante.

Mbledhjen e kryesoi: Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 04.02.2015;
3. Diskutim lidhur me Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, e ftuar Ferdije Zhushi –Etemi, Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë;
4. Të ndryshme

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur me 04.02.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 04.02.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, e ftuar Ferdije Zhushi –Etemi, Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

Nait Hasani, theksoi se Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport ka pasur takime me përfaqësues të Universiteteve Publike dhe ka vendosur që në kuadër të kësaj ta ketë edhe një takim me Agjencionin e Akreditimit, në mënyrë që të njoftohet me rrjedhat e fushës së Akreditimit dhe për gjendjen në Universitetet publike edhe kolegjet private.

Ferdije Zhushi Etemi, kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë, i njoftoi anëtarët e Komisionit se Agjencia e Akreditimit është themeluar në vitin 2008 dhe që prej atëherë realizon procesin e Akreditimit që është vlerësim i jashtëm i cilësisë i të gjitha Institucioneve të arsimit të lartë në Kosovë. Akreditimi bëhet në periudha ciklike, 3-5 vjet. Vlerësimin e Institucioneve e bënë një panel i ekspertëve ndërkombëtar dhe në bazë të rekomandimeve që ka dhënë ekipi vlerësues Këshilli Shtetëror i Cilësisë merr vendimin për Akreditimin apo për mos Akreditimin e Institucionit i cili është vlerësuar.

Agjencia është plotësisht e pa varur në vendimet e saj dhe procedura e Akreditimit i ka katër hapa, e para është vlerësimi i brendshëm nga ana e Institucionit, paraqitja e atij vlerësimi në aplikacion, faza tjetër është seleksionimi i ekspertëve në bazë të fushës, formimi i ekipit për vlerësim dhe shkuarja në vizitë në Institucionin i cili vlerësohet. Hapi final është procedura Follow up apo procedura e vazhdimsisë ku institucionet janë të obliguara që të përpilojnë një raport të përmirësimit dhe të përmbushjes së obligimeve që ekspertët kanë dhënë në raportin e vlerësimit.

Sa i përket sektorit privat ajo tha se cilësia ndryshon shumë prej një institucioni në një institucion dhe se numri i tyre është i madh, por Agjencia e ka për obligim t'i akreditoi institucionet të cilat kanë një raport pozitiv prej ekspertëve ndërkombëtar.

Salih Morina, shtroi çështjen e përbërjes së Këshilli Shtetëror të Cilësisë, cilësinë e studimeve në kolegjet private, stafin akademik, numrin e studentëve në këto kolegje si dhe problematiken e regjistrimit në këto kolegje. Kërkon që Ministria të ofron më shumë programe të reja të studimeve në mënyrë që të kemi kuadro të reja për treg.

Bekim Haxhiu, shtroi pyetjen se pse studentët të cilët i kanë përfunduar studimet në sektorin privat kanë vështirësi që të vazhdojnë studimet e tyre në sektorin publik, ndërsa ka qenë e kundërta tek ata të cilët kanë përfunduar studimet në sektorin publik. Një çështje tjetër shqetësuese sipas tij është edhe procesi i Akreditimit të studimeve Master dhe të Doktoratës, ky proces është i kushtëzuar nga numri, hapësira dhe për nga vitet.

Ismajl Kurteshi, tha se janë Akredituar drejtimet për të cilat nuk ka nevojë tregu i punës dhe shtroi pyetje se cili institucion është përgjegjës për Akreditimin e drejtimeve të cilat janë të pa nevojshme. Në vijim tha se nëse rekomandimet ndërkombëtare janë vendimtare për akreditim a do të thotë kjo që jeni të pavarur nga institucionet vendore dhe vareni nga të huajt, çka ka ndërmerr Agjencioni për përmirësimin e cilësisë dhe sa e ka dëmtuar akuza për korrupsion kredibilitetin e Agjencionit.

Shukrije Bytyqi, theksoi se kusht primar për akreditimin e një Universiteti përveq tjerash është infrastruktura dhe stafi i mësimdhënësve. Ajo tha se dhe puna praktike do duhej të jetë një prej kushteve për akreditimin e universiteteve dhe kolegjeve, dhe shtroi pyetjen për mos akreditimin programit të matematikës në kuadër të shkencave matematike natyrore.

Teuta Haxhiu, shtroi çështjen e numrit të anëtarëve të Këshillit, si dhe emërimit të bartësve privat të arsimit të lartë, a është Akredituar ndonjë nga bartësit me emërtimin universitet privat apo kolegji universitarë dhe çka është bërë me ato kolegje të cilat janë mbyllur, dhe çka do të ndodhë me studentët. Më tej shtroi dilemën edhe mbi adresat elektronike të kolegjeve të cilat figurojnë UNI, problemet me licensimin e diplomave të mësimdhënësve dhe institucionet që bëjnë thirrje për regjistrimin e studentëve pa provim shtetëror të maturës, a është akredituar ndonjë program i cili nxjerr mësimdhënës, si dhe foli për çështjen e akuzës për korrupsion të Agjencionit.

Nait Hasani, theksoi se është e rëndësishme që znj. Zhushi Etemi të njihet me problemet që ne i kemi hasur në teren. Një ndër to është problemi se ka shumë student në programin Ekonomik, Juridik dhe Shkencat Humanitare. Tek cilësia theksoi se të dhënat mbi njohurit e lëndës së matematikës nga ana e mësimdhënësve është 24% dhe nga lënda e gjuhës shqipe 30-34%.

Ferdije Zhushi Etemi, theksoi se sa i përket procesit të akreditimit, e kemi dëshmuar se e bëjmë në mënyrë profesionale sikurse të gjitha agjencitë në Evropë dhe se Anëtarësimi i Agjencisë së Akreditimit në ENQA mundëson që diplomat e Kosovës edhe të sektorit privat edhe sektorit publik të pranohen shumë më lehtë në vazhdimin e studimeve jashtë. Ajo tha se Agjencia nuk është e kënaqur me cilësi në arsim, dhe ajo çka është e rëndësishme është që sipas ligjit ti ndajnë detyrat me Ministrinë.

Znj. Zhushi Etemi iu përgjigj pyetjeve të parashtruara duke thënë se Këshilli Shtetëror i Cilësisë nuk është i plotë për shkak se prof. Sabri Hamiti dhe Sadik Idriz kanë dhënë dorëheqje, dhe se së shpejti do të bëhet plotësimi i Këshillit me dy anëtarë të tjerë.

Pyetjes se a ka konflikte interesi, iu përgjigj se është përgjegjësi ekskluzive e Ministrisë kur të emërojnë kandidatët .

Lidhur me Kolegjet private, ajo tha se me ligj është e rregulluar dhënia e titujve në sektorin privat dhe kjo asnjëherë nuk është implementuar nga ministria, pra këtu institucionet private janë dëmtuar dukshëm.

Sa i përket regjistrimit pas përfundimit të afatit theksoi se i takon Ministrisë që të caktojë datën se kur duhet të bëhet mbyllja e librit Amë dhe një prej masave që mund të mirret për ta ndaluar këtë dukuri është digjitalizimi i listës së studentëve të regjistruar.

Për çështjen e programeve të njejta ajo tha se sipas ligjit ne jemi të detyruar të trajtojmë çdo aplikacion që na vjen, rregullimin e tregut, kufizimet i vendos MASHT-i. Sa i përket çështjes së vazhdimit të studimeve prej sektorit privat në atë publik ajo theksoi se kjo është një ikje e ballafaqimit me konkurrencën nga sektori publik, kështu që në këtë rastë bëhet një shkelje e të drejtave të studentëve të sektorit privat. Për çështjen e studimeve master dhe të doktoratës, ajo tha se kemi fusha në të cilat nuk kemi mundësi që të ofrojmë programe të doktoratës, për shkak se kërkesat për infrastrukturë hulumtuese janë shumë të larta dhe të shtrenjta dhe institucionet nuk arrijnë që ti përmbushin, dhe nuk mund ta akreditojmë një program të Doktoratës pa një udhëheqës të doktoratës në vendin tonë dhe theksoi se janë të gatshëm të pranojmë aplikacionet e reja në studimet e doktoratës por vetëm aty ku përmbushen kriteret. Agjencia vazhdimisht ka njoftuar opinionin për akreditimin e institucioneve por edhe kur ka ndonjë institucion të dyshimtë, ka pas dy degë të kolegjit Universum që kanë qenë të pa akredituara, dhe një universitet i quajtur Anadollu që funksionon në Prizren dhe kemi kërkuar nga inspeksioni i MASHT-it që ta inspektoj.

Nait Hasani, tha se Ministri nuk ka lëshuar vendimin, vetëm ka dhënë deklaratë për opinion se nuk ka marrë vendim, ndërsa universiteti ka hapur degë në Graçanicë dhe në Prishtinë janë financuar nga Ministria e Jashtme dhe ajo e Drejtësisë në këtë Universitet 20 studentë dhe janë bërë pagesa në shumë 14000 euro për secilin studentë.

Ferdije Zhushi Etemi, tha se këtij Universiteti që konsiderohet ilegal i kemi kërkuar disa herë të vijë në Agjenci, që tu nënshtrohet proceseve të akreditimit, të cilin proces ky institucion nuk e ka bërë asnjëherë dhe që sot e kësaj dite funksionon në mënyrë ilegale. Sa i përket drejtimeve për të cilat nuk ka nevojë tregu, ne sipas ligjit jemi të obliguar që ti trajtojmë të gjitha aplikacionet, ndërsa politikat për nevojat e tregut i bën Qeveria dhe Ministria e Arsimit. Sa i përket akuzës për korrupsion, tha se Agjecioni është akuzuar pikërisht prej institucioneve të cilat nuk janë akredituar, dhe se kjo ka ndikuar në reputacionin e Agjencisë, ndërsa sa i përket hapësirës si kusht, tha se hapësira është e kënaqshme në disa institucione. Matematika ka qenë problem për shkak të mos dërgimit me kohë të aplikacionit për shkak të ndërrimeve të menaxhmentit. Agjencia e Akreditimit e ka pranuar aplikacionin në qershor dhe e ka bërë Akreditimin me procedura të shpejta duke mundësuar që studentët që presin të studiojnë matematikë, të regjistrohen dhe se nuk ka matematikë në asnjë institucion privat. Ajo tha se nuk është akredituar ndonjë bartës nga kolegjet si Universitet dhe shumë herë në media ka cekur se nuk ka universitet privat, ka vetëm kolegje.

Sa i përket adresave elektronike ku figuron emërtimi UNI theksoi se është evidente që i përdorin dhe manipulojnë dhe se duhet të bashkëpunojmë me Ministrinë që ti kontrollojmë së bashku dhe të ju dërgohet një vërejtje këtyre kolegjeve.

Në sektorin privat asnjë program i edukimit nuk është akredituar, programet që janë akredituar në mirëqenie të fëmijëve janë vetëm programet e fushës së sociologjisë. Ajo shtoi se edhe sa i përket çështjes së nostrifikimit kanë bërë me dije se cilat diploma

nostrifikohen në Kosovë dhe mësimëdhënësit janë të obliguar që ti nostrifikojnë diplomat ndërsa institucionet janë të obliguara mos të pranojnë staf me diploma të pa nostrifikuara.

Nait Hasani, falendëroi znj. Zhushi Etemi për infomatat dhe shtoi se do të ftohen që të jenë pjesëmarrës në debatet që do ti kenë, për të amendamentuar një ligj që do tu shërbejë të gjithëve.

Ferdije Zhushi Etemi, ftoi anëtarët e Komisionit që të marrin pjesë në procesin e akreditimit dhe të njoftohen për së afërmi me këtë proces.

4.Të ndryshme

Për këtë pikë të rendit të ditës nuk pati diskutim.

Mbledhja përfundoi në orën 13:20.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani